



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SHPLLJE PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të nenit 20 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi të AMA-s Nr. 30 datë 16.04.2015, Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Nr. 77/2018 “Për një ndryshim në vendimin nr.19/2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës në R.SH”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurat për rekrutim për pozicionin:

- 1 (një) Kryetar i Këshillit të Ankesave, Kategoria II-b

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE: 11.03.2022

Përshkrimi i punës:

Qëllimi:

Hartimi, mbikqyrja dhe zbatimi i kodeve të transmetimit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, mbi respektimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut, mbrojtjen e të miturve, dhe të së drejtës për informim. Ndërgjegjësimi publik lidhur me veprimtarinë e OSHMA-ve, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruara. Të rekomandojë modifikime të rregulloreve dhe akteve ligjore dhe nënligjore.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

A. Të koordinojë punën e Këshillit të Ankesave së bashku me dy kolegët e tij (anëtarë të këshillit të ankesave), të ndajë detyrat dhe rendin e trajtimit të ankesave.

B. Të mbikëqyrë zbatimin e kodeve dhe rregulloreve nga OSHMA-të dhe RTSH-ja, sipas përcaktimeve të ligjit 97/2013. Të shqyrtoj ankesat ndaj OSHMA-ve.

C. Jep udhëzime mbi përgatitjen dhe publikimin e udhëzimeve për OSHMA-të, me qëllim realizimin e përcaktimeve të ligjit 97/2013 .

Ç. Të sigurojë trajtimin e shqyrtimit të çdo ankese, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve të rregulloreve të transmetimit të shprehura në nenin 47 të ligjit 97/2013 .

D. Merr masa për sigurimin e organizimit të seancave dëgjimore me palët, ankuesin dhe OSHMA-n.

Dh. Merr masa për përgatitjen (edhe me ekspertizë të pavarur) të anketime të publikut mbi problemet etike të programeve dhe cilësinë e tyre në perceptimin publik.

E. Kujdeset që çdo 6 muaj të botohet një përmbledhje e përfundimeve të arritura nga Këshilli, në një buletin i cili botohet nga AMA.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

Kritere të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

Kritere të posaçme:

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” ose ekuivalente me to, në Shkenca Komunikimi, Gazetari, Drejtësi. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtat fusha.
- Të ketë të paktën 10 vjet eksperiencë pune me kohë të plotë në media.

Përbën avantazh:

- Kandidatët me përvojë pune mbi 3 vite në mësimdhënie në nivelet Bachelor ose Master në Shkencat e Komunikimit ose Gazetarisë;
- Kandidatët që kanë pjesëmarrje në grupe pune për ekspertizë ose studime mbi aspekte të zhvillimit të medias në Shqipëri (të paraqiten referencat përkatëse);

Dokumentacioni:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të Autoritetit të Mediave Audiovizive dokumentat si më poshtë:

- a) Jetëshkrim
- b) Kërkesë;
- b) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- c) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

- ç) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, pjesëmarrje në grupe pune;
- d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- dh) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- e) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- f) Referencat përkatëse për të përforcuar aplikimin e tyre.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 11.03.2022

Adresa: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr 15, Tiranë.

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Pas datës, 11.03.2022, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë do të shpallë në faqen zyrtare të AMA-s listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të listuara në shpallje.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë nëpërmjet adresës së tyre të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidaturat e paraseleksionuara për pozicionin e Kryetarit të Këshillit të Ankesave i paraqiten Anëtarëve të AMA-s. Në bazë të pikës 1, neni 20 të ligjit 97/2013, përzgjedhja e kandidatit fitues bëhet me shumicë të cilësuar.